Via Circonvallazione 5 – 10015 IVREA
Tel 0125/48046-47

KANCELARISË TREGTARE TË GJYKATËS SË IVREAS

PUSHIM NGA DETYRA

I nënshkruari

SERGIO CAMPAGNUOLO, lindur në Ivrea në datë 10.06.1960, me vendbanim po aty në Stradale
Torino n.c. 84
Shtetas italian

KOMUNIKON

Që me proces verbal të Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe të Zakonshme datë 26.02.1992, Nr.
Rep. 74011/9748; në terma rregjistrimi, i marrë si akt publik nga Noter Dr. Pierluigi CIGNETTI, i
shoqërisë:

“S.T.G. S.r.l.”

Me seli në Ivrea, Via Cascinette n.c.17

I regjistruar në nr. 5340 të Regjistrat të Shoqërive të kësaj Gjykate, i gjithë Këshilli Administrativ i
përfaqësuar nga zotërinjtë:

SERGIO CAMPAGNUOLO, me gjeneralitete si më sipër, Kryetar i Këshillit Administrativ;
ANTONIO CAMPAGNUOLO, lindur në Pavone Canavese më 16.12.1954, me vendbanim në
Chiaverano, Case Sparse n.c. 3, Zëvendës Kryetar, ka dhënë dorëheqjen e vet, që asambleja e ka
pranuar dhe,

KËRKON

Që për sa më sipër të bëhet transkriptimi në regjistrat e Kësaj Kancelarie

KËRKON

Që sa më sipër të bëhet transkriptimi në Regjistrat e kësaj Kancelarie.

Bashkëngjitur: Vërtetimi i derdhjes.

Ivrea, më 26 shkurt 1992

VËRTETIM FIRME

Ivrea, më 26 shkurt 1992

Unë i nënshkruari dr. Pierluigi Cignetti, Noter në IVREA, i regjistruar në Kolegjin e Noterëve të Rrethit të Bashkuara të Ivrea dhe Aosta vërtetpë që zotërinjtë e partpërmendur për identitetin personal të të cilëve unë Noteri jam i sigurt, të paralajmëruar në bazë të nenit 26 të Ligjit 4 janar 1968 nr. 15 kanë bërë dhe kanë firmosur në praninë time deklaratën e mësipërme:

SERGIO CAMPAGNUOLO, lindur në Ivrea në 10.06.1960, po aty me vendbanim në Stradale Torino n.c 84

PIERLUIGI CIGNETTI
NOTER
Via Circonvallazione 5 – 10015 IVREA
Tel 0125/48046-47

KANCELARISË TREGTARE TË GJYKATËS SË IVREAS

SHËNIM PËR TRANSKRIPTIM

I nënshkruari

Dr. Pierluigi Cignetti, Noter në Ivrea

I regjistruar në Dhomën e Noterëve të Rretheve të Bashkuara të Ivreas dhe Aostas

DEPOZITON

Kopje njësoj me origjinalin të aktit publik, dokument i hartuar prej tij në datë 26.02.1992, Nr. Rep. 74.011/9.748, në terma të regjistrimit, të homologuar në datë 13 mars 1992, që ka Proçes verbalin e Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe të zakonshme të Shoqërisë:

“S.T.G. S.r.l.”

E regjistruar pranë kësaj Kancelarie në nr. 5340 të regjistrit të shoqërive.

PJESA E ZAKONSHME

Emërim i Organit Administrativ për arsye dorëheqje të të gjithë Këshillit Administrativ.

PJESA E JASHTËZAKONSHME

Rishikim i plotë i statutit të shoqërisë.

Vetë Noteri,

Kërkon

Që, pasi të verifikohet përmbushja e saktë e kushteve ligjore të procedohet me transkriptimin në Regjistrat e kësaj Kancelarie.

Bashkëngjit: vërtetim të derdhjes së taksës

Kërkon

Që për sa më sipër të bëhet transkriptimi në Regjistrat e kësaj Kancelarie

Bashkëngjit: Vërtetim të derdhjes.

Ivrea, më 26 shkurt 1992

(firma)

VËRTETIM FIRME

Ivrea, më 26 shkurt 1992

Unë i nënshkruari dr. Pierluigi Cignetti, Noter në IVREA, i regjistruar në Kolegjin e Noterëve të Rrethit të Bashkuara të Ivrea dhe Aosta vërtetpë që zotërinjtë e partpërmendur për identitetin personal të të cilëve unë Noteri jam i sigurt, të paralajmëruar në bazë të nenit 26 të Ligjit 4 janar 1968 nr. 15 kanë bërë dhe kanë firmosur në praninë time deklaratën e mësipërme:

SERGIO CAMPAGNUOLO, lindur në Ivrea në 10.06.1960, po aty me vendbanim në Stradale Torino n.c 84

PIERLUIGI CIGNETTI
NOTER
Via Circonvallazione 5 – 10015 IVREA
Tel 0125/48046-47

Repertori nr. 74.01/1

Koleksioni: 9748

Regjistruar në Ivrea në 05.03.1992 në nr. 484, Vol. --, paguar L. 101800

PROÇES VERBAL I ASAMBLESE SË JASHTËZAKONSHME DHE TË ZAKONSHME TË
ORTAKËVE TË SHOQËRISË "S.T.G. S.r.l."

REPUBLIKA ITALIANE

Sot në datë 26 (njëzet e gjashtë) shkurt njëmijë e nëntëqind e nëntëdhejtë e dy, në Ivrea, në katin e parë të ndërtesës që gjendet në Via Circonvallazione n.c. 5 dhe në studion time,

Në orën dhjetë (h. 10,00)

Përpara meje dr. Pierluigi Cignetti, Noter në Ivrea, i regjistruar në Dhomën e Noterëve të Rretheve të Bashkuara të Ivreas dhe Aostas,

Me heqjen dorë paraprakisht, me konsensusin tim, me ndihmën e dëshmitarëve,

U paraqit zoti:

SERGIO CAMPAGNUOLO, lindur në Ivrea më 10 qershor 1960, po aty me vendbanim në Stradale Torino n.c. 84, sipërmarrës, mbajtës i Kodit Fiskal nr. CMPSRG60H10E379V, i cili merr pjesë në këtë akt në cilësinë e kryetarit të Këshillit Administrativ të shoqërisë

"S.T.G. S.r.l."

Me seli në Ivrea, Via Cascinette n.c. 17, kapitali themeltar L. 20.000.000 i derdhur i tëri, e regjistruar në Kancelarinë Tregtare të Gjykatës së Ivreas në nr. 5340 të Regjistratit të Shoqërive, në C.C.I.A.A. të Torinos në nr. 745.226 të Regjistratit të Firmave, mbajtëse e kodit fiskal dhe Niptit nr. 05912500013.

I paraqituri, për identitetin personal të të cilit unë Noteri jam i sigurt më kërkon që të hartoj proçes verbalin e asamblesë së zakonshme dhe të jashtëzakonshme të shoqërisë së lartpërmendur në këtë ditë, orë dhe vend e thirrur dhe e mbledhur për të diskutuar dhe vendosur për të mëposhtmin

REND TË DITËS

PJESA E JASHTËZAKONSHME

Rishikim i plotë i statutit të shoqërisë dhe përgatitja e një statuti të ri të përditësuar.

PJESA E ZAKONSHME

Emërim të Organit Administrativ për dorëheqje të të gjithë Këshillit Administrativ.

Në bazë të nenit 12 të statutit të shoqërisë, e merr drejtimin i paraqituri i cili

PASI KONSTATON

- Që është i pranishëm i gjithë kapitali themeltar;
- Që është i pranishëm Organi Administrativ i përbërë nga zotërinjtë sergio CAMPAGNUOLO, Kryetar, i paraqituri i sotëm, Antonio COMPAGNUOLO, Zëvendës Kryetar;
- Që nuk ekziston Kolegji i Ekspertëve Kontabël të Miratuar;
- Që pjesëmarrësit deklarojnë se janë mjaftueshmërisht të informuar për argumentat e shtruar në rendin e ditës dhe që pranojnë diskutimin e tyre pa asnjë rezervë;

E DEKLARON

Asamblenë të mbledhur në formë totalitare në mbledhjen e jashtëzakonshme dhe të zakonshme dhe si të tillë të aftë për të diskutuar dhe për të vendosur për argumentat e shtruar në rend të ditës, duke më rikonfirmuar mua noterit detyrën për të hartuar këtë proces verbal.

PJESA E JASHTËZAKONSHME

Kryetari, duke filluar trajtimin e pikës së vetme të rendit të ditës, fton duke ilustruar arsyet që kanë shtyrë për të rishikuar tërësisht statutin e shoqërisë me qëllimn për të bërë ndryshimet që konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për t'i përshtatur shoqërisë interesat e reja që ajo vetë ka ndër mend që të ndjekë, si edhe për arsyet me karakter ekskluzivisht civilistik.

Në vazhdim të propozimit të vet Kryetari lexon të gjithë tekstin e statutit të shoqërisë që është duke u ndryshuar, që përfshin të gjitha ndryshimet që do të vendosen.

Prandaj fton asamblenë që të diskutojë dhe të vendosë.

Vazhdon një diskutim i gjerë në përfundim të të cilit Asambleja në unanimitet

VENDOS

Që të miratojë si statut të ri të shoqërisë atë që është ilustruar më përpara nga Kryetari, që përmban të gjitha ndryshimet e propozuara nga ai, me qëllim që ta bëjë më organik, jo nën profilin civilistik, por edhe nën atë thjesht praktik dhe funksional.

PJESA E ZAKONSHME

Zotërinjtë Sergio CAMPAGNUOLO dhe Antonio CAMPAGNUOLO deklarojnë se japin dorëheqje si Administratorë pjesë e Këshillit Administrativ.

Ortakët pranojnë këto dorëheqje dhe falenderojnë Administratorët që japin dorëheqjen për aktivitetin e ushtruar deri tani në favor të shoqërisë.

Me propozim të ortakut Asambleja në unanimitet emëron, pa afat kohor të përcaktuar, si Organ Administrativ të shoqërisë një Administrator të Vetëm të përfaqësuar nga zoti:

SERGIO CAMPAGNUOLO, me gjeneralitete si më sipër, të cilit do t'i takojnë përfaqësimi ligjor i shoqërisë përballë të tretëve dhe në gjykim dhe të gjitha tagrat e administrimit siç parashikohet nga statuti i shoqërisë.

Atij do t'i takojë, përveç kompensimit që asambleja do të caktojë në fillim të çdo viti ushtrimor, një kompensim për përfundimin e raportit të punës që duhet të llogaritet në masë përqindje me pesëmbëdhjetë për qind (15%) të shumës së përgjithshme të kompensimeve të dhëna çdo vit nga Asambleja e Ortakëve.

Asambleja i jep detyrë Kryetarit që t'i bëjë këtij proces verbal, vetëm për pjesën e jashtëzakonshme, dhe statutit që pasi m'u dorëzua mua Noterit i bashkëngjitet këtij proces verbal nën gërmën "A", të cilat nuk u lexuan për arsye çlirimi nga ky detyrim, të gjithë ndryshimet që do të bëhen të nevojshme dhe të dobishme me kërkesë të Autoritetit Gjyqësor kompetent në momentin e omologimit dhe të regjistrimit.

Duke mos qenë asgjë tjetër për të vendosur dhe duke qenë se asnjë tjetër nuk e kërkon fjalën Kryetari e deklaroi të shpërndarë asamblesë, në orën dhjetë e tridhjetë minuta (h. 10.30)

Shpenzimet në ngarkim të shoqërisë.

Pasi m'u kërkuar unë Noteri kam marrë këtë proces verbal, të shkruar nga person i imi i besuar atje ku nuk është shkruar nga dora ime;

Proces verbal të asamblesë, që unë ja lexoj të paraqiturit që e miraton dhe me mua Noterin e firmos në bazë të ligjit.

Zë pesë fletë me dy faqe.

Sergio Campagnuolo (firma)

(firma, vula e noterit)

SHTOJCA "A" I AKTIT

NË DATË 26.02.1992

Nr. Rep. 74.011/9748

STATUTI I SHOQËRISË

KAPITULLI I PARË – THEMELIMI I SHOQËRISË

Neni 1 – Lloji dhe Emërtimi

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur

"S.T.G. srl"

Neni 2 – Selia

Shoqëria e ka selinë ligjore në Via Cascinette, 17 – 10015 Ivrea (TO)

Mund të hapen ose mbyllen si në lokalitete të tjera të territorit kombëtar ashtu edhe jashtë shtetit seli dytësore, degë, agjensi, depozita dhe fabrika, drejtori, akte dhe zyra të çdo lloji.

Vendbanimi i ortakëve, për atë që ka të bëjë me raportet e tyre me shoqërinë, është ajo që rezulton nga libri i ortakëve.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet deri në 31 dhjetor 2030 dhe mund të shtyhet, një ose më shumë herë, ose mund të priset përpara kohe me vendim të Asamblesë.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

- Zhvillimin, për llogari të vet dhe/ose të të tretëve, të aktiviteteve që kanë të bëjnë me prodhimin, përpunimin, tregtimin me shumicë dhe pakicë të artikujve dhe produkteve për veshje, këpucëve dhe aksesorëve të ndryshëm për veshjet dhe më specifikisht të mallrave të hedhura në shitje në lidhje me Tabelat Merceologjike IX, X dhe XIV nr. 31, 41 dhe 50;
- Furnizimi të tretëve i shërbimeve për arredimin e brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë arredimin e dyqaneve dhe zyrave;
- Kryerjen e shërbimeve të administrimit dhe të ndërmjetësimit imobiliar;
- Autotransport të sendeve për llogari të të tretëve;
- Si edhe çdo aktivitet tjetër i lidhur direkt apo indirekt me këto, për llogari të vet apo të të tretëve.

Për arritjen e objektit të shoqërisë, Shoqëria gjithashtu mund:

- a) Të bëjë të gjitha operacionet mobiliare, imobiliare, tregtare, industriale, financiare, qeraje dhe hipotekore, që konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme, përfshirë këtu marrjen e kredive edhe fondiare;
 - b) Të japë garanci, fidejusione (garanci bankare) dhe çdo lloj tjetër garancie, edhe reale;
 - c) Të kryejë aktivitet financiar, çbllokimi fondesh dhe rekuperimi kredish dhe administrime titujsh;
 - d) Të marrë, me çdo lloj forme, direkt dhe indirekt kuota dhe pjesëmarrje në shoqëri të tjera, Ente, Ndërmarrje dhe Organizma, të krijuara dhe që do të krijohen, që kanë edhe qëllim jo të ngjashëm apo analog me të vetin ose sidoqoftë të lidhur me të vetin, si direkt ashtu edhe indirekt;
 - e) Të marrë mandate agjensie dhe përfaqësimi të lidhura me aktivitetet e specifikuar më sipër.
- Të gjitha operacionet e blerjes, shitjes dhe administrimit të pasurive të tundshme dhe të patundshme të përmendura më sipër i referohen si pronësisë së plotë ashtu edhe uzufruktit, ashtu edhe pronësisë nudo dhe të drejtave të pjesshme në përgjithësi që kanë të bëjnë me pasuritë e lartpërmendura.

KAPITULLI I DYTË – KAPITALI THEMELTAR

Neni 5 – Kapitali themeltar

Kapitali themeltar është prej 20.000.000 (njëzet milionë) lireta, i ndarë në kuota me shumë jo më të vogël se sa 1.000 (një mijë) lireta ose shumëfishi i tyre.

Kapitali themeltar mund të rritet edhe me anë të prurjeve apo kontributeve në natyrë, që duhet të bëhen me respektim të mënyrave sipas neneve 2342 dhe 2343 të Kodit Civil në fuqi.

Për të lejuar arritjen më të mirë të objektit të shoqërisë, ortakët mund të vënë në dispozicion të shoqërisë fonde të tjera apo mjete financiare të tjera, si nën formën e derdhjes në llogari kapitali apo në llogari të shtimit të ardhëm të kapitalit, ashtu edhe në formën e kredisë.

Neni 6 – Transferim i kuotave

Kuotat janë të transferueshme me akt mes të gjallëve ose me trashëgimi për shkak vdekje.

Transferimi i kuotave ka efekt përballë shoqërisë nga momenti i regjistrimit në librin e ortakëve. Regjistrimi i transferimit mund të bëhet me kërkesë të shitësit apo të blerësit pas paraqitjes së titullit nga i cili të rezultojë transferimi, ose me anë të deklaratës në librin e ortakëve të firmosur nga shitësi dhe nga blerësi dhe të firmosur edhe nga Kryetari i Këshillit Administrativ ose nga Administratori i Vetëm.

Blerja e një kuote sjell pranimin nga ana e blerësit të të gjitha marrëveshjeve sociale që përmbahen në statut.

Ortaku nuk mund të transferojë me akt mes të gjallëve falas kuotën e vet, me efekt ndaj shoqërisë pa marrë miratimin paraprak të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.

Në rast transferimi me akt mes të gjallëve, kuotat duhet t'i ofrohen në opsion ortakëve të tjerë nëpërmjet organit administrativ ose me anë të komunikimit me shkrim, me letër rekomande me njoftim marrje, duke specifikuar, në të dyja rastet, kuotën e vënë në shitje, çmimin, mënyrat e blerjes dhe afatet e pagesës. Në rast se nuk arrihet marrëveshja për çmimin, caktimi i tij do t'i dërgohet një Kolegji Arbitrash sipas nenit 27 të mëposhtëm.

Ortakët mund të ushtrojnë, në raport me kuotat e zotëruara nga secili, të drejtën e opsionit brenda një muaji nga njoftimi i çmimit siç është vendosur më sipër.

Në hipotezën kur një ose më shumë ortakë nuk kanë për qëllim që të ushtrojnë të drejtën e parablerjes, ortakët e tjerë që e kanë ushtruar këtë të drejtë parablerje kanë mundësinë që të bëhen blerës të kuotave të mbetura, gjithmonë në raport me kuotat e zotëruara prej tyre.

Kuotat duhet të transferohen brenda një muaji nga data në të cilën Kryetari i Këshillit Administrativ ose Administratori i Vetëm do t'i ketë komunikuar Ortakut Ofrues me komunikim me shkrim me njoftim marrje, pranimin e ofertës me paraqitjen e emrave të personave që kanë pranuar dhe të sasisë që duhet t'i transferohet secilit prej tyre.

Pasi skadon afati prej një muaji nga njoftimi i çmimit të shitjes, e drejta e opsionit, nëse nuk është ushtruar, do të shuhet dhe Ortaku që ka ndër mend të shesë kuotën e vet do të jetë i lirë që t'ia bëjë këtë shitje të tretëve brenda afatit tjetër prej 6 (gjashtë) muajsh, pasi kalon pa rezultat ky afat, ortaku duhet të përsërisë të gjithë procedurën e parashikuar në paragrafet e mëparshme.

Me transferim nënkuptohet jo vetëm transferimi i pronësisë së plotë të kuotave, por edhe ai i pronësisë së pastër apo të ndonjë të drejte tjetër reale mbi to. Në këtë rast oferta e opsionit do të ketë për objekt të drejtën reale.

Transferimi i kuotave të tretëve të huaj mund të bëhet menjëherë në rast se rezulton konsensusi me shkrim i të gjithë Ortakëve të tjerë.

Neni 7 – Tërheqja e Ortakut

Ortakët që kundërshtojnë vendimnet që kanë të bëjnë me ndryshimin e objektit të shoqërisë, të llojit të shoqërisë ose transferimin e selisë së shoqërisë jashtë shtetit kanë të drejtë të tërhiqen nga shoqëria dhe të marrin rimbursimin e kuotave të veta në raport me kapitalin e vet që rezulton nga bilanci i fundit i miratuar rregullisht.

Neni 8 – Vdekja e ortakut

Në rast vdekje të njërit prej Ortakëve, të tjerët duhet t'ia likuidojnë kuotën trashëgimtarëve, duke respektuar mënyrat e parashikuara në nenin 7 të mëparshëm, përveç kur preferojnë të prishet shoqëria, ose ta vazhdojnë atë me vetë trashëgimtarët dhe nëse këta do të pranojnë.

KAPITULLI I TRETË – ORGANET E SHOQËRISË

Neni 9 – Organet e Shoqërisë

Janë organe të Shoqërisë:

- a) Asambleja e Ortakëve;
- b) Këshilli Administrativ dhe Administratori i Vetëm;
- c) Kolegji i Ekspertëve Kontabël të Miratuar, nëse kërkohet nga Ligji ose i emëruar nga Asambleja, edhe e zakonshme.

KAPITULLI I KATËRT – ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Neni 10 – Asambleja e Ortakëve

Asambleja e Ortakëve, e mbledhur rregullisht, përfaqëson tërësinë e Ortakëve dhe vendimnet e tyre, të marra në përputhje me Ligjin dhe me këtë Statut, kushtëzojnë të gjithë Ortakët edhe pse jo pjesëmarrës apo kundërshtues, edhe në rastet kur është pranuar tërheqja.

Asambleja përbëhet nga të gjithë Ortakët të regjistruar në librin e ortakëve, që mund të marrin pjesë personalisht ose me anë të përfaqësuesve të deleguar në bazë të nenit 2372 të Kodit Civil në fuqi, nga të gjithë Administratorët në detyrë dhe, nëse ka të emëruar, nga Ekspertët Kontabël të miratuar efektivë.

Çdo kuotë prej 1.000 (një mijë) liretash jep të drejtën për një votë.

Konstatimi i mbledhjes ligjore të Asamblesë bëhet nga Kryetari i Asamblesë, edhe pasi bëhet ky konstatim, vlefshmëria e vendimeve të saj nuk mund të kontestohet për abstenim të votës apo për largim të mundshëm të pjesëmarrësve, që verifikohen gjatë mbledhjes për çdo lloj arsyeje apo motivi.

Neni 11 – Thirrja e asamblesë

Asambleja e Ortakëve, si e zakonshme ashtu e jashtëzakonshme, thirret nga organi administrativ, në çdo lokalitetet, mjafton që të jetë në Itali, me telegram dhe/ose me letër rekomande që duhet të dërgohet, edhe dorazi, të paktën 8 (tetë) ditë përpara mbledhjes. Njoftimi i thirrjes duhet të përmbajë listën e çështjeve që do të trajtohen, si edhe datën, orën dhe vendin e mbledhjes dhe ndoshta datën, orën dhe vendin e thirrjes së dytë.

Janë të vlefshme Asamblëtë e thirrura edhe pa formalitetet e lartpërmendura në rast se përfaqësohet i gjithë kapitali themeltar dhe asistojnë të gjithë Administratorët në detyrë dhe Ekspertët kontabël të miratuar, nëse ka të emëruar. Megjithatë në këto hipoteza secili prej pjesëmarrësve mund të kundërshtojë diskutimin e argumentave për të cilat e konsideron veten të informuar në mënyrë jo të mjaftueshme. Gjithashtu organi administrativ është i detyruar të thërrasë pa vonesë Asamblenë e Ortakëve, sa herë që do të bëjnë kërkesë aq ortakë që përfaqësojnë të paktën një të pestën e kapitalit themeltar me letër rekomande me njoftim marrje me argumentat që do të trajtohen. Mbledhja duhet

të rezultojë e caktuar në një ditë që përfshihet në afatin maksimal prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së kërkesës së thirrjes së Asamblesë.

Asambleja mund të thirret si në formën e zakonshme ashtu edhe të jashtëzakonshme.

Neni 12 – Asambleja e Zakonshme

Asambleja e zakonshme:

- a) Miraton bilancin ushtrimor;
- b) Emëron dhe revokon Administratorin e Vetëm, anëtarët e Këshillit Administrativ, Ekspertët kontabël të miratuar dhe Kryetari i Kolegjit të ekspertëve kontabël të miratuar;
- c) Përcakton kompensimin e Administratorit të Vetëm, të anëtarëve të Këshillit Administrativ dhe të Ekspertëve Kontabël të Miratuar;
- d) Vendos për përgjegjësinë e Administratorit të Vetëm, të anëtarëve të Këshillit Administrativ dhe të ekspertëve kontabël të miratuar;
- e) Vendos për shkeljen e ndalimit të konkurrencës, të parashikuar nga neni 2390 të Kodit Civil në fuqi, nga ana e Administratorit të Vetëm ose të anëtarëve të Këshillit Administrativ;
- f) Vendos për akte të tjera që kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë, që i rezervohen kompetencës së tij në bazë të Ligjit ose që i nënshtrohen shqyrtimit të tij nga organi administrativ, për të cilët nuk parashikohet shqyrtimi nga ana e Asamblesë së jashtëzakonshme ose të organeve të tjera të shoqërisë.

Asambleja e zakonshme thirret të paktën një herë në vit brenda 4 (katër) muajsh ose, në rast nevojash të veçanta, brenda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e ushtrimit të shoqërisë për qëllimet e miratimit të mundshëm të bilancit të shoqërisë.

Asambleja e zakonshme mbledhet rregullisht, në thirrje të parë, me praninë e aq ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit themeltar.

Në thirrje të dytë ajo është rregullisht e mbledhur cilado qoftë pjesa e kapitalit e përfaqësuar nga Ortakët pjesëmarrës.

Asambleja e zakonshme, si në thirrje të parë ashtu edhe në të dytën, vendos me votën pro të të paktën 51% (pesëdhjetë e një për qind) të ortakëve të pranishëm.

Neni 13 – Asambleja e Jashtëzakonshme

Asambleja e Jashtëzakonshme:

- a) Vendos për ndryshimet e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të Shoqërisë;
- b) Vendos për transferimet me akt mes të gjallëve falas të kuotave të shoqërisë;
- c) Vendos gjithashtu për emërimin dhe për tagrat e Likuidatorëve;
- d) Vendos për aksionet e përgjegjësisë ndaj likuidatorëve.

Si në mbledhjen e parë, ashtu edhe të dytë ajo vendos me votën pro të aq ortakëve sa përfaqësojnë të paktën 2/3 (dy të tretat) e kapitalit themeltar.

Neni 14 – Drejtimi i asamblesë

Asambleja drejtohet nga Administratori i vetëm ose nga Kryetari i Këshillit Administrativ, ose, në rast mungese apo pengese të këtij, nga Zëvendës Kryetari i Këshillit Administrativ ose nga një Ortak tjetër i caktuar nga pjesëmarrësit.

I takon Kryetarit të Asamblesë të drejtojë dhe të rregullijë në bazë të ligjit diskutimin dhe të përcaktojë mënyrat për votimet e veçanta.

Për hartimin e proces verbalit, Asambleja emëron sekretarin, që mund edhe të mos jetë ortak, me përjashtim kur në asamble të jashhtëzakonshme, kur thirret një noter për të bërë sekretarin.

Proces verbalet e mbledhjeve duhet të firmosen nga Kryetari dhe nga Sekretari; në raste të veçanta mund të kërkohet firma e të gjithë pjesëmarrësve.

KAPITULLI I PESTË – ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI

Neni 15 – Administratori i Vetëm dhe Këshilli Administrativ

Shoqëria administrohet nga një Administrator i Vetëm ose nga një Këshill Administrativ i përbërë të paktën nga 2 (dy) anëtarë, të zgjedhur edhe mes jo ortakëve.

Administratorët qëndrojnë në detyrë pa afat kohor të përcaktuar dhe janë të rizgjedhshëm. Ata mund të revokohen në çdo moment nga Asambleja edhe pa një arsye të drejtë.

Nëse nuk i ka marrë masat Asambleja e Ortakëve, Këshilli Administrativ zgjedh mes anëtarëve të tij një Kryetar dhe ndoshta një ose më shumë zëvendës kryetarë, dhe mund të emërojë një ose më shumë Administratorë të deleguar. Gjithashtu mund të përcaktohet se edhe kujt t'i atribuohet firma e shoqërisë.

Neni 16 – Mbledhjet e Këshillit Administrativ

Këshilli Administrativ mbledhet periodikisht në çdo vend, sipas nevojave të administrimit. Ajo thirret nga Kryetari ose nga Zëvendës Kryetari me letër rekomande që përmban rendin e ditës që duhet të dërgohet të paktën 5 (pesë) ditë përpara mbledhjes ose, në rastet e urgjencës, me telegram që duhet të dërgohet të paktën një ditë përpara ose edhe me një komunikim të thjeshtë telefonik.

Në mungesë të këtyre formaliteteve dhe të afateve të thirrjes sipas paragrafit të mëparshëm, Këshilli vendos vlefshmërisht me praninë e të gjithë Administratorëve në detyrë dhe Ekspertëve kontabël të miratuar, nëse ka të emëruar.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit Administrativ, ose, në rast mungese apo pengese të këtyre, nga Zëvendës Kryetari i Këshillit Administrativ ose nga një Këshilltar tjetër të emëruar nga pjesëmarrësit.

I takon Kryetarit të mbledhjes të drejtojë dhe të rregullojë në bazë të ligjit diskutimin dhe të përcaktojë mënyrat për votimet e veçanta.

Për vlefshmërinë e vendimeve është e nevojshme prania e shumicës së Administratorëve në detyrë dhe miratimi i dy të tretave të administratorëve të pranishëm. Në rast barazimi mbizotëron vota e kryetarit të Këshillit Administrativ.

Konstatimi i mbledhjes ligjore të Asamblesë bëhet nga Kryetari i mbledhjes, dhe sapo bëhet ky konstatim, vlefshmëria e vendimeve të saj nuk mund të kontestohet për abstenim të votës apo për largimin e mundshëm të pjesëmarrësve, që verifikohet gjatë mbledhjes për çdo lloj arsye dhe motivi.

Vota e një anëtarit të Këshillit Administrativ nuk mund të jepet me përfaqësim.

Proçes verbalit e mbledhjeve të Këshillit Administrativ firmosen nga Kryetari dhe nga një sekretar që mund të zgjidhet edhe jashtë Këshillit, Në raste të veçanta mund të kërkohet firmosja e Proçes verbalit nga ana e të gjithë pjesëmarrësve.

Administratori, që në një operacion të caktuar ka, për llogari të vet apo të të tretëve, interesa në konflikt me ato të shoqërisë, është i detyruar të njoftojë administratorët e tjerë dhe, për këtë, të mos marrë pjesë në vendimet që kanë të bëjnë me vetë operacionin. Në mungesë, është i detyruar të përgjigjet për humbjet e mundshme që i kanë ardhur shoqërisë nga bërja e operacionit.

Neni 17 – Tagra të Administratorit të vetëm dhe të këshillit Administrativ

Administratori i Vetëm i ka të gjitha tagrat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm.

Këshilli Administrativ i ka të gjitha tagrat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund t'i delegojë njërit ose më shumë anëtarëve, bashkarisht ose veç e veç, të gjitha ose një pjesë të tagrave të veta.

Neni 18 – Tagrat dhe aktet që nuk mund të delegohen

Nuk mund të delegohen, përveç attributeve të parashikuara nga nenet 2423, 2443, 2446 dhe 2447, realizimi i akteve të mëposhtme:

- a) Përcaktimi i adresimit të përgjithshëm të administrimit dhe të aktivitetit prodhues;
- b) Blerje dhe shitje e pasurive të patundshme dhe e të drejtave imobiliare, të komplekseve të ndërmarrjeve dhe të kuotave në shoqëri të tjera
- c) Blerje e pasurive instrumentale me karakter inovativ dhe strategjik;
- d) Grumbullim kursimesh mes ortakëve, Administratorëve dhe vartësve të shoqërisë, në bazë të ligjit, edhe me anë të emetimit të titujve në seri të ngjashme me obligacionet;
- e) Firmosja ose dhënia e garancisë për kambialet pasive, lëshimi i garancive bankare apo garancive reale, si edhe autorizimet për të krijuar hipoteka apo barra mbi pasuritë e shoqërisë.

Neni 19 – Tagrat e kryetarit të Këshillit Administrativ të Zëvendës kryetarit

Me përjashtim të ndonjë vendimi të ndryshëm të Këshillit Administrativ, Kryetarit dhe Zëvendës Kryetarit i delegohen të gjitha tagrat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm me përjashtim të atyre që nuk mund të delegohen me ligj dhe të atyre të përjashtuara nga neni 18 i mëparshëm.

Si rrjedhojë, Kryetari i Këshillit Administrativ dhe Zëvendës Kryetari, pavarësisht nga vendimet specifike të Këshillit, mundet, për shembull:

- a) Të lidhin dhe të prishin kontrata blerje të lëndëve të para dhe ndihmëse dhe të mallrave të përdorimit shumëvjeçare me karakter inovativ, të konsideruara të nevojshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë;
- b) Të lidhin dhe të prishin kontrata shitje të mallrave objekt i prodhimit apo tregtimit të shoqërisë, përfshirë mbetjet e çdo lloji, duke përcaktuar çmimet dhe kushtet;
- c) Të lidhin dhe të zgjidhin çdo kontratë tjetër që ka të bëjë me dhënien e shërbimeve në përgjithësi, si tendera, transporte, qera, asikuracione, kredi, depozita, mandate dhe prokura, raporte pune në vartësi dhe autonome me karakter rastësor dhe të vazhdueshëm;
- d) Të bëjë operacione bankare dhe financiare të çdo natyre, të firmosë çeqe dhe kambiale, të xhirojë kambiale dhe tituj të tjerë krediti, të bëjë pagesa dhe arkëtime duke lëshuar fatura;
- e) Të përfaqësojë dhe të impenjojë shoqërinë në çdo operacion pranë Enteve Publike, Gjyqësore, Financiare, Të sigurimeve, të Sindikatave, si edhe pranë Hekurudhave të Shtetit, Administratës Postare, Doganave, Cassa depositi e prestiti, thesarit;
- f) Të firmosë letërshkëmbimin si edhe të gjitha aktet në lidhje me tagrat e dhëna.

Neni 20 – Tagrat e Këshillëtarëve të deleguar

Këshilltarëve të deleguar nuk mund t'i delegohen tagra dhe attribute të ndryshme ose jo në përputhje me ato të parashikuarat nga neni 19 i mësipërm për Kryetarin e Këshillit Administrativ dhe Zëvendës Kryetarin.

Neni 21 – Përfaqësimi

Tagrat e përfaqësimit të shoqërisë përballë të tretëve dhe në gjykim i takojnë përkatësisht Administratorit të Vetëm ose Kryetarit të Këshillit Administrativ, dhe në mungesë të tij, Zëvendës kryetarit, veç e veç mes tyre.

Neni 22 – Kompensimet për administratorët

Anëtarëve të Këshillit Administrativ ose Administratorit të Vetëm i takon një shpërblim vjetor i përcaktuar nga Asambleja e Ortakëve, si edhe rimbursimi analitik ose në fund të listës i shpenzimeve të bëra për arsye të detyrës së tyre. Këto kompensime përbëjnë një kosto për shoqërinë.

Kompensimet mund të përcaktohen në formë fikse ose në formë medalje pranie apo pjesëmarrje në fitime.

Për kompensimet, nëse njëkën, bëhet dakord me vendim të marrë nga Asambleja e Ortakëve në fillim të çdo viti.

Këshilli Administrativ, pasi dëgjon mendimin e Kolegjit të Ekspertëve Kontabël të miratuar, nëse ka, përcakton kompensimet që i takojnë Këshilltarëve të Deleguar, në lidhje me punën me kërkesë të tyre për përmbushjen e mandatit.

Gjithashtu, Asambleja e Ortakëve dhe Këshilli Administrativ, në rastet e parashikuara nga dy paragrafet e mëparshme, mund të ëprcaktojnë në favor të administratorëve ose të Këshilltarëve të Deleguar rezervën vjetore të një shume si titull dëmshpërblimi për marimin e raportit, që duhet të llogaritet në masë përqindje të kompensimeve vjetore dhe që duhet të paguhet brenda dhe jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e mbarimit të vetë raportit. Masa e kësaj rezerve vjetore do të vendoset çdo vit nga Asambleja e Zakonshme e Ortakëve, njëkohësisht me caktimin e kompensimit vjetor. Shuma e vena mënjane si rezerë do të llogariten në llogari specifike individuale të akredituara për administratorët e veçantë dhe do të jenë pa interes dhe nuk do t'i nënshtrohen asnjë forme rivlerësimi monetar.

Detyrimi për të paguar kompensimet sipas pikës së mësipërme, mund edhe të garantohet nëpërmjet lidhjes së një police sigurimi.

KAPITULLI I GJASHTË – KOLEGJI I EKSPERTËVE KONTABËL TË MIRATUAR

Neni 23 – Kolegji i ekspertëve kontabël të miratuar

Kolegji i ekspertëve kontabël të miratuar, në rast se kërkohet nga ligji apo emërohet nga Asambleja e zakonshme, përbëhet nga 3 (tre) ekspertë kontabël të miratuar efektive dhe 2 (dy) ndihmës, të zgjedhur dhe që funksionojnë në bazë të ligjit.

KAPITULLI I SHTATË – USHTRIMET E SHOQËRISË DHE BILANCI

Neni 24 – Ushtrimi i shoqërisë dhe Bilanci

Ushtrimi i shoqërisë koïncidon me vitin kalendarik, dhe domethënë fillon në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo ushtrimi, organi administrativ, brenda afatit dhe nën respektimin e dispozitave ligjore, merr masat për hartimin e bilancit me llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve, si edhe të një relacioni mbi ecurinë e administrimit të shoqërisë.,

Këto dokumenta duhet t'i nënshtrohen miratimit të Asamblesë së Ortakëve në respektim të afateve dhe sipas mënyrave të parashikuara nga ligji.

Neni 25 – Destinacioni i fitimeve

Fitimet e ushtrimit, pasi, zbritet 5% (pesë përqind) për të krijuar fondin e rezervës së zakonshme (deri sa kjo të ketë arritur 1/5 (një të pestën) e kapitalit themeltar) do të ndahen mes ortakëve në proporcion me kuotat përkatëse të kapitalit, me përjashtim të ndonjë vendimi të ndryshëm të asamblesë.

Fitimet të pa marra do të shkojnë në favor të fondit të rezervës, pasi kalojnë 5 (pesë) vjet nga dita në të cilën bëhen të kërkueshme

KAPITULLI I TETË – NORMATIVAT TRANZITORE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26 – Prishja dhe likuidimi

Në rast se në çdo moment dhe për çdo lloj shkak do të shkohet në prishjen e shoqërisë, Asambleja e jashtëzakonshme përcakton mënyrat e likuidimit dhe emëron një ose më shumë likuidatorë, duke i përcaktuar tagrat dhe kompensimet.

Neni 27 – Kolegji i arbitrave

Çdo mosmarrëveshje që ka lindur ose që mund të lindë mes ortakëve apo ata që kanë të drejtë në vartësi të kësaj kontrate, do t'i dërgohet për gjykim një arbitri me përbërje miqësore, të emëruar në marrëveshje mes palëve.

Në rast mosmarrëveshje për emërimin, zgjidhja e mosmarrëveshjes do t'i besohet gjykimit të tre arbitrave me përbërje miqësore që duhet të emërohen njëri nga secila palë dhe i treti me marrëveshje të përbashkët nga dy arbitrat të emëruar kështu, dhe në mungesë nga Kryetari i Gjykatës së Ivreas (TO).

Arbitri ose Kolegji i arbitrave do të gjykojnë në formë “ex bono et aequo”.

Neni 28 – Kompetenca gjyqësore

Shoqëria i nënshtrohet juridiksionit të autoritetit gjyqësor të shkallës së parë dhe të Gjykimit administrativ të Ivreas (TO).

Neni 29 – Emërimi i Detyrave të Shoqërisë

Për herë të parë, detyrat e shoqërisë emërohen me Aktin e themelimit.

Neni 30 – Dispozitat përfundimtare

Për gjithshka që nuk është parashikuar shprehimisht nga ky statut aplikohen dispozitat e Kodit Civil dhe të ligjeve të tjera në fuqi në këtë fushë.

Kopje njësoj me origjinalin, lëshohet për përdorime të lejuara nga ligji.

Ivrea, më 25 mars 1992

(firma dhe vula e noterit)

FATURË

LLOGARI POSTARE

Mandat për derdhjen e: LIRETA 236.0000

Lireta: dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë

Në llogarinë nr. 8003

Në emër të ZYRËS SË REGJISTRIT, QERAVE DHE TAKSAVE PËR KONCESIONET
QEVERITARE TË ROMËS.

Bërë nga PIERLUIGI CIGNETTI, NOTER

Vula e postës mban data 23 mars 1992

FATURË

LLOGARI POSTARE

Mandat për derdhjen e: LIRETA 20.0000

Lireta: njëzet mijë

Në llogarinë nr. 00566018

Në emër të ZYRËS SË REGJISTRIT DOMANIUMIT TË ROMËS.

Bërë nga PIERLUIGI CIGNETTI, NOTER

Vula e postës mban data 23 mars 1992

Pierluigi Cignetti noter në Ivrea

Lindur në Strambino (TO) më 18.06.1950

Vendbanimi fiskal: 10019 Strambino – Via Belvedere, 34

NIPTI: 03982600011

Kodi Fiskal: CGN PLG 50H18 I970N

Përktheu: ANILA BERBERI



FATURË

LLOGARI POSTARE

Mandat për derdhjen e: LIRETA 236.0000

Lireta: dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë

Në llogarinë nr. 8003

Në emër të ZYRËS SË REGJISTRIT, QERAVE DHE TAKSAVE PËR KONCESIONET
QEVERITARE TË ROMËS.

Bërë nga PIERLUIGI CIGNETTI, NOTER

Vula e postës mban data 23 mars 1992

FATURË

LLOGARI POSTARE

Mandat për derdhjen e: LIRETA 20.0000

Lireta: njëzet mijë

Në llogarinë nr. 00566018

Në emër të ZYRËS SË REGJISTRIT DOMANIUMIT TË ROMËS.

Bërë nga PIERLUIGI CIGNETTI, NOTER

Vula e postës mban data 23 mars 1992

Pierluigi Cignetti noter në Ivrea

Lindur në Strambino (TO) më 18.06.1950

Vendbanimi fiskal: 10019 Strambino – Via Belvedere, 34

NIPTI: 03982600011

Kodi Fiskal: CGN PLG 50H18 I970N

PROKURORIA E REPUBLIKES
PRANE GJYKATES
IVREA

APOSTILA

(Konventa e Hagës datë 5 Tetor 1961)

Shteti: ITALI

Ky akt Publik

është firmosur nga Z. CIGNETTI PIERLUIGI

në cilësinë e noterit të IVREA

është i pajisur me vulën/pullën e CIGNETTI PIERLUIGI

VËRTETOHET

në IVREA, në datë 13 Gusht 2019,

nga Prokurori i republikës së IVREA Fernando Giuseppe
me nr. 137/19

Prokurori i republikës

Dr. Giuseppe Fernando

Vula/Pulla

Firma:

I nënshkruari prokuro i republikës
Dr. Alessandro GALLO
(firma dhe vula)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 4352 Rep

Tirane, me 02.09.2019

VERTETIM PERKTHIMI

Në përputhje Ligjit Nr.110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine", unë Noter Ermal Xh. Hamzaj vertetoj nenshkrimin e perkthyeses Anila Berberi, e njohur nga une noteri personalisht, e cila deklaroi se dokumenti bashkelidhur është perkthyer prej saj nga gjuha Italisht ne gjuhen Shqip ne perputhje me originalin.

REPUBBLICA D'ALBANIA
ALBO NOTARILE DI TIRANA
N. 4352 Rep

Tirana, il 02.09.2019

PULLE TARIFE



NOTER
Ermal Xh. HAMZAJ
ERMAL XH. HAMZAJ

CERTIFICATO DI TRADUZIONE

Ai sensi dell'art della legge. N. 110/2018, io notaio Ermal Xh. Hamzaj, certifico la sottoscrizione del traduttore la sigg.ra Anila Berberi conosciuta da me notaio personalmente, la quale ha dichiarato che il documento in allegato e' stato tradotto da lei da Italiano in Albanese, in conformità col originale.

NOTAIO

Ermal Xh. HAMZAJ

ERMAL XH. HAMZAJ

